

PROBLEME SOCIALPSIKOLOGJIKE ME ADOLESHENTËT ME PRINDËR TË DIVORCUAR

Divorcet janë një dukuri e zakonshme në jetën e përditshme bashkëshortore. Në ShBA, çdo vit më shumë se 1 milion fëmijë rriten me prindër të divorcuar; në Britani, 40% e fëmijëve të lindur janë fëmijë familjesh me një prind.

Në vendin tonë, vitet e fundit kurba e divorceve është në ngritje. Po rritet numri i grave që kërkojnë të ndahen, të divorcohen. E gjejmë në të gjitha mjediset, por më shumë në qytet.

Divorci ka ndikimin negativ, jo vetëm te prindërit (çift), por dhe te fëmijët e tyre. Adolehentët që e kanë përjetuar ndarjen e prindërve, në këtë periudhë janë më të ndjeshëm. Janë në një moshë që i kuptojnë pasojat e ndarjes. Janë të rritur dhe e ndiejnë veten të fyer para bashkëmoshatarëve të tyre. Kanë folur për prindërit e tyre me superlativa, kurse tani nuk dinë çfarë të thonë. Janë në moshën që kanë nevojë më shumë për këshillat, sugjerimet dhe ndihmën e të dy prindërve, kurse tani njeri u mungon. Në 76.2% të rasteve te kjo kategori fëmijësh mbizotëron mërzia, melankolia, trishtimi, pasiguria për jetën, pesimizmi.

“Pse poezia ime u bë kaq e trishtë, pse zemra ime veç dhembjes i këndon, pse jeta ime është kaq e brishtë, pse syri im shpesh e shpesh loton”. (L., nxënëse e vitit të tretë).

Këshillat e të dy prindërve, ndihma e vazhdueshme e tyre, kujdesi i tyre i pandërprerë i pjek më shumë adolehentët, i bën ata më rezistentë dhe më të aftë për të kapërcyer vështirësitë e moshës e të jetës. Kur ajo është e pjesshme, gjendja shpirtërore e tyre përkeqësohet: “Përpëlitem ndër ethe, e mbërthyer këtu në heshtjen time. Jam brenda vetes sime e s’ dal dot prej saj. Kam mbetur kështu, oh prej sa kohësh!” (S., nxënëse e vitit të parë). Madje ndonjëri, djali, thërret edhe vdekjen: “Eh, vdekje, eja të më marrësh, ty po të pres!

Dëgjon apo s' dëgjon?!... Jam më mirë me ty se me jetën e mallkuar të pabesë. Shpesh mendoj më mirë të vdes sesa të jetoj". (Xh., nxënës i vitit të tretë). Ata janë të pakënaqur, jo vetëm me veten e tyre, me fatin e tyre, por dhe me njerëzit që i rrethojnë, me realitetin ku jetojnë. Në fund të fundit, revolta e tyre drejtohet edhe kundër opinionit që bën sehir (e kërkojnë edhe ndihmën e tij).

"O njerëz të marrë! Nuk e kuptoni se po vrisni vetveten, se po vdisni së gjalli!" Akuza e tyre është e rëndë, e pamëshirshme. Zgjidhja: një botë tjetër, një realitet i zi, një besim i ri që t' i japë një kuptim tjetër jetës së tyre.

"Dua të pi, të dehem, të bëhem tapë, të harroj realitetin, të humbas sensin e dhimbjes, të shpik një botë tjetër". (I., nxënës e vitit të tretë). Adoleshenti me prindër të divorcuar është gjithmonë i tensionuar. Nuk ka besim te vetja dhe gjithmonë është i shqetësuar se mos vepron gabim. Edhe kur gjithçka ecën mirë, ai shqetësohet për të ardhmen dhe, për rrjedhojë, e ka të vështirë të qetësojë veten. Një burim domethënës i stresit dytësor tek adoleshentët është shqetësimi posttraumatik nga humbja apo ndarja nga prindi. Vetë ata e shprehin gjendjen e tyre shpirtërore, me pak fjalë, tepër prekëse e domethënëse. "Fjalët: vetmi, brengë, trishtim i përshtaten gjendjes sime shpirtërore... Shpesh gjendje pandërgjegjësie!!!... Vazhdoj të endem e mbajtur ndaj heshtjes. Mbetem të jem një e sëmurë ndjenjash, mendimesh të çakërryer". (J., nxënës e vitit të katërt). Ose: "Mallkimi jam unë... Unë jam askush".

Siç shihet, kjo moshë, veçanërisht 17-18-vjeçarët, lexojnë Frojдин, Niçen dhe ndikohen prej tyre. (Ndikimi në kahun negativ është më i madh pikërisht te kjo kategori adoleshentësh me prindër të divorcuar). U duket se në veprat e tyre gjejnë vetveten. Prandaj është e domosdoshme që të planifikohen biseda e të organizohen diskutime për teoritë e Frojdit e të Niçes, të ftohen shkencëtarë e psikologë të mëdhenj për të kuptuar thelbin e tyre. Të zhgënjyer nga prindërit e tyre që u dukeshin engjëj, por në të vërtetë nuk u dolën ashtu, urrejtja e tyre për ta shumohet e shumohet pa kufi: "Edhe fytyra më e dashur të bëhet armike, edhe buzëqeshja më e ëmbël shndërrohet në ngërdheshje të pështirë dhe neveritëse". (L., nxënës e vitit të tretë). Ose: "I miri...!!! E kush mund të përcaktojë shkallën e mirësisë së njeriut?!" (A., nxënës e vitit të katërt).

Fëmijët mund të mendojnë se, nëse mami apo babi është i keq,

unë jam pjesë e tyre. Si pasojë, edhe unë jam i keq (Terapistja amerikane Miriam Galper Cohen). Kjo ndikon në vlerësimin me objektivitet të vetvetes dhe e bën indiferent, inferior në komunikimet e marrëdhëniet e adoleshentit me të tjerët, veçanërisht me shokët dhe shoqet. Njerëzit martohen sepse “u pëlqen”, sepse “dashurohen” dhe qëndrojnë së bashku përderisa vazhdojnë të pëlqehen, përderisa vazhdojnë të quhen të dashuruar. Ndarja e tyre, divorci i një çifti nuk do të thotë se ata janë të këqij. Ata u ndanë se nuk e dashuronin më njëri-tjetrin ose kishin projekte plotësisht të ndryshme nga njëri-tjetri, por nuk e dinin para se të martoheshin ose u lindën pas martesës. Një marrëdhënie nuk mund të krijohet mbi dobësinë... Marrëdhëniet njerëzore kërkojnë vendosmëri, angazhim, përgjegjësi. Një çift, edhe pse mund të ketë probleme, pranon të rrijë bashkë për hir të fëmijëve, për arsye ekonomike, se i tremben opinionit, rrinë bashkë se nuk kanë nga t’ia mbajnë, se nuk besojnë te një lidhje tjetër më të mirë, se kanë frikë aventurat.

Ndarja e prindërve, veçanërisht te fëmijët e rritur, lë mbresa të pashlyeshme. Ata e përshkruajnë me dhimbje të thellë këtë moment. Të përjetosh thyerjen e martesës së prindërve të tu, mund të jetë një nga gjërat më të dhimbshme që mund të imagjinohen.

“Atë mëngjes isha në një ankth shumë të madh. Në sallën e gjyqit shikoja fytyrat e mamasë e të babait. Ata ishin të shqetësuar se me cilin do të shkonim unë dhe motra. Kur gjykata vendosi që ne do të ishim me mamënë, mua m’u thye zemra, sepse mendoja se nuk do të rrija më me babanë dhe nuk do të kaloja ato momente të bukura që kisha kaluar me prindërit e mi, nuk do të kisha më ngrohtësinë e babait tim, nuk do të kisha më mbrojtjen e tij, as përkëdheljet e tij. - Çdo të shtunë dal me babain dhe, kur kthehem, jam e mërzhitur”. (S., nxënëse e vitit të parë).

22.8% e fëmijëve me prindër të divorcuar rrinë me babain, kurse 77,2% me mamënë. Vajzat e ndiejnë më shumë mungesën e babait, sepse tradicionalisht ato janë më shumë të lidhura me të. Kur u mungon dashuria dhe kujdesi i babait, vajzat janë të prirura të kenë fëmijë jashtë martese ose të bien pre e prostitucionit. Sipas prof. Brus Elis nga Zelanda e Re, “Vajzave pa baballarë ose me baballarë që sillen ashpër ose ftohtë me to, pjekuria ose menstruacionet e para u vijnë më shpejt. Është vërtetuar se kur babai kujdeset për vajzën e tij kur ajo është e vogël, ndodh një fenomen i çuditshëm: vajza,

pasi marthohet, bëhet shumë shpejt me bebe”.

Adoleshentët e gjykojnë normale dhe të pranueshme ndarjen, kur prindërit shahen, grinden, zihen, madje edhe qëllohen me grushte. Për ta “më mirë kështu, se secili nga prindërit e mi është i lumtur”. Adoleshentët me prindër të divorcuar shohin në ëndrra momente nga jeta kur të dy prindërit jetonin bashkë dhe ngjarje që lidhen me prindërit e tyre, edhe pse të ndarë tani. Ndodh pikërisht ajo që e shpjegon Frojdi: “Figurat simbolike të ëndrrës fshehin, në shumicën e rasteve, dëshira të ndrydhura ose të paplotësuara, të cilat, meqenëse s’kanë mundur të realizohen gjatë ditës, përpiqen të hyjnë në jetën tonë nëpër shtegun e ëndrrave” ose, siç e thotë bukur një fjalë e urtë kineze: “Çka mblidhet thellë në zemër, del me teshtimë në ëndërr”.

Adoleshentët me prindër të divorcuar e pëlqejnë natyrën dhe e përshkruajnë bukur. I duan zogjtë, kafshët shtëpiake (macen, qenin). Duke luajtur me to, largojnë stresin. Mezi presin të vijë t’i marrë babai. Shkojnë me të te njerëzit e tij, dalin për të ngrënë drekë ose darkë në ndonjë lokal, diskutojnë dhe kalojnë momente të bukura. Nga të afërmit e prindërit me të cilin nuk jetojnë bashkë, më shumë të lidhur janë me gjyshen dhe gjyshin, me hallat dhe tezet. Nënata në përgjithësi janë më të ftohta dhe më të distancuara nga fëmijët e tyre, kur nuk i kanë me vete, kur fëmijët jetojnë me baballarët e tyre.

Vetëm 43.8% e prindërve të divorcuar kujdesen për fëmijët e tyre kur nuk jetojnë me ta (Përgjithësisht ata me arsim të lartë). Një pjesë e prindërve, edhe pse të divorcuar, mirëkuptohen me njëri-tjetrin për problemin e fëmijëve dhe kjo ndikon pozitivisht te fëmijët, i bën ata më optimistë për jetën, u largon atyre mërzinë, u rrit humorin dhe mban gjallë dashurinë për të dy prindërit (njësoj).

Sipas A., nxënëse e vitit të parë: “Babai përpiqet që të mos mërzitemi dhe të jemi gjithmonë të lidhur me familjen e tij... Megjithëse gjyshi ka vendosur të dalim vetëm të shtunave, ne me babanë tonë dalim edhe ditëve të tjera dhe mamaja nuk na pengon. E mira e këtij divorci është që prindërit tanë merrem vesh me njëri-tjetrin shumë mirë për problemin tonë dhe kjo na bën që edhe ne të ndihemi shumë mirë”.

Kur ndarja ka vite që është bërë dhe njëri nga prindërit është martuar, mungon interesimi për fëmijën e tij, me të cilin nuk jeton. Martesa e dytë e njërit nga prindërit ia shkatërron shpresën fëmijës

se prindërit një ditë do të bashkohen përsëri. Sipas Miriam Galper Cohen "Rimartesat janë pjesa më e vështirë e një jete të trazuar, e cila kërkon shumë durim, kohë, humor dhe bisedë. Fëmijët e kanë të vështirë të ambientohen me një partner të ri".

Adoleshentët, në varësi të marrëdhënieve që ata kanë me prindërit jashtë shkollës dhe të marrëdhënieve të vetë çiftit që është ndarë, reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj prindit, me të cilin nuk jetojnë, kur ai vjen në shkollë. Kur prindërit nuk u ushqejnë urrejtjen për njëri-tjetrin (pavarësisht se janë ndarë, por i edukojnë me dashurinë për babain apo nënën, e presin me kënaqësi takimin (Në 35,8% të rasteve). Pak për një shoqëri të civilizuar. Kjo tregon se përgjithësisht marrëdhëniet midis burrit e gruas, kur ata divorcohen, janë të acaruara, mungon mirëkuptimi midis tyre dhe kjo ndikon edhe te fëmijët (në varësi me cilin prej tyre jetojnë). Shprehja "u ndanë si njerëzit" dëgjohet pak në realitetin shqiptar... Sa më patriarkalë të jenë prindërit e divorcuar, sa më egocentristë të jenë, sa më pak të kulturuar e të adoptuar me normat e edukatës shoqërore, aq më shumë ndikime negative mund të ushtrojnë mbi fëmijët... Burri dhe gruaja që janë divorcuar në rrethana të reja, nuk ka pse të mos kenë një minimum mirësjelljeje për njëri-tjetrin, kur është e nevojshme edhe një minimum lidhjesh për fëmijët, për probleme financiare. ... 27.5% e adoleshentëve nuk duan t'i takojnë, 20% i takojnë me indiferencë dhe e shprehin këtë, madje edhe para shokëve apo shoqeve të tyre, dhe 14,3% i urrejnë. Kjo shprehet edhe në marrëdhëniet me njerëzit e afërt të babait ose të mamasë, me të cilët nuk jeton. Divorci i prindërve lë gjurmë në jetën e çdo fëmije. (Këtu nuk përjashtohen edhe gjenitë). Gëte thoshte: "Askush s' duhet të besojë se mund t'u shpëtojë përshtypjeve të rinisë së vet".

Bibliografia:

1. Alberoni Françesko, "Të dua", ShB "Mësonjëtorja e parë", Tiranë 2001.
2. Cvajg, S. "Frojdi", ShB "Fan Noli", Tiranë 1992.
3. Dolto, Fransuaze "Adoleshenca", Uegen 2003.
4. Libri "Të rinjtë pyesin", Tiranë 1996.
5. Mill, "Mbi lirinë", Pejë 1998.